

Në bazë të nenit 77-k paragrafi (5) i ligjit për kulturë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 dhe 11/18) dhe nenit 29 të Statutit të Institucionit Nacional Galeria Nazionale e Maqedonisë – Shkup nr. 01-269/3 nga 03.07.2015, Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Institucionit Nacional Galeria Nazionale e Maqedonisë – Shkup nr. 02-77/4 nga 02.02.2018 dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Institucionit Nacional Galeria Nazionale e Maqedonisë – Shkup nr. 01-152/2 nga 12.03.2018, me propozim të drejtorit të Institucionit Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, më datë 17.02.2021, e miratoi rregulloren në vijim:

RREGULLORE

për kriteret më të afërta për realizimin e vlerësimit të efektit të ofruesve të shërbimeve publike në kulturë, shumën e shpërblimit në para ose lloj tjetër të shpërblimit material ose jomaterial, zvogëlimin e rrogës ose sistematizim në vendin e punës në nivel më të ulët në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret më të afërta për realizimin e efektit të ofruesve të shërbimeve publike në kulturë, shumën e shpërblimit në para ose lloj tjetër të shpërblimit material ose jomaterial, zvogëlim të rrogës ose sistematizim në vendin e punës në nivel më të ulët në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup.

Neni 2

Vlerësimi i efektit të ofruesve të shërbimeve publike në kulturë në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup bëhet me qëllim për të marrë një pasqyrë reale për profesionalizëm, cilësi, efikasitet dhe efektivitet në kryerjen e detyrave zyrtare, përkatësisht realizimin e qëllimeve të përcaktuara të punës.

Sistemi për menaxhim me efektin

Neni 3

(1) Institucioni Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup vendos sistem për menaxhim me efektin e ofruesve të shërbimeve publike në kulturë.

(2) Sistemin nga paragrafi (1) të këtij neni, e përbëjnë :

- përcaktimi i qëllimeve dhe detyrave të punës;
- përcaktimi i planit individual për përsosje profesionale dhe
- procedura për vlerësim të efektit të ofruesve të shërbimit publik në kulturë.

Përcaktimi i qëllimeve dhe detyrave të punës

Neni 4

(1) Qëllimet dhe detyrat e punës të ofruesit të shërbimit publik në kulturë përcaktohen në bazë të programit vjetor për punë të Institucionit Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë – Shkup.

(2) Qëllimet dhe detyrat e punës të ofruesit të shërbimit publik në kulturë duhet të jenë të qartë, precize, të matshme dhe me kornizë të përcaktuar kohore për kryerje, e gjatë përcaktimit të tyre duhet të merren parasysh niveli i vendit të punës dhe komunat dhe kompetencat e veçanta të ofruesve të shërbimit publik në kulturë.

(3) Qëllimet dhe detyrat e punës përcaktohen nga i punësuar i drejtpërdrejtë epror në Institucionet Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup me status të ofruesit të shërbimeve publike në kulturë në bashkëpunim me ofruesin e drejtpërdrejtë më të ulët të shërbimit publik në Institucionit Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, pas përfundimit të procedurës për vlerësim të arritjeve të punës, në muajin dhjetor gjatë vitit kalendarik rrjedhës, për vitin e ardhshëm kalendarik.

Përcaktimi i planit individual për përsosje profesionale

Neni 5

(1) Nevoja për përsosje profesionale të ofruesit të shërbimeve publike në kulturë, për shkak të kryerjes efikase të qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara të punës dhe nevoja për zhvillim dhe avancim të kompetencave të punës, përcaktohet në planin individual për përsosje profesionale.

(2) Plani individual për përsosje profesionale përcaktohet nga punonjësi i drejtpërdrejtë epror në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup me status të ofruesit të shërbimit publik në kulturë në bashkëpunim me ofruesin e drejtpërdrejtë më të ulët të shërbimit publik në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup efekti i të cilit, monitorohet, pas vendosjes së qëllimeve dhe detyrave të punës.

(3) Gjatë përcaktimit të planit individual për vlerësim profesional merren parasysh nevoja për zhvillim dhe avancim të kompetencave të punës të ofruesit të shërbimeve publike në kulturë, për shkak të kryerjes efikase të qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara nga neni 3 i kësaj rregulloreje, si dhe për shkak të mundësisë për avancim.

Monitorimi i vazhdueshëm i efektit

Neni 6

(1) Punonjësi i drejtpërdrejtë epror në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë periudhës së vlerësimit, e monitoron vazhdimisht punën e ofruesit të shërbimit publik në kulturën dhe mbledh të dhëna që janë me rëndësi esenciale për vlerësim.

(2) Monitorimi dhe mbledhja e të dhënave nënkupton kontroll dhe evidentim të cilësisë dhe sasisë në realizimin e qëllimeve dhe detyrave të punës. s

(3) Gjatë monitorimit të punës, punonjësi si drejtpërdrejtë epror në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut e motivon

vazhdimisht ofruesin e shërbimit publik në kulturë dhe i jep instruksione dhe këshilla për përmirësim në punë, i sugjeron detaje konkrete në punë, procedurat që çojnë në punë të suksesshme dhe mangësitë në punën e tij.

Intervistë gjysmëvjetore Neni 7

(1) Punonjësi i drejtpërdrejtë epror në Institucionin Nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, me Status të ofruesit të shërbimit publik në kulturë është i detyruar që vazhdimisht ta monitorojë efektin e ofruesit të drejtpërdrejtë më të ulët të shërbimit publik në Galerinë Nationale të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup gjatë gjithë vitit dhe sipas nevojës të propozojë masa për përmirësim të tij.

(2) Si pjesë e procesit të ndjekjes së vazhdueshme të efektit të ofruesit të shërbimit publik në kulturë, më së voni deri më 31 maj në vitin kalendarik, realizohet intervistë gjysmëvjetore.

(3) Pas realizimit të intervistës gjysmëvjetore në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni plotësohet raport për intervistë gjysmëvjetore, të cilin e nënshkruajnë ofruesi i shërbimit publik në kulturë, efekti i të cilit monitorohet dhe punonjësi i tij i drejtpërdrejtë epror me status të ofruesit të shërbimit publik në kulturë.

(4) Kopje të raportit nga paragrafi (3) i këtij neni, i dorëzohet ofruesit të shërbimit publik në kulturë efekti i të cilit monitorohet.

(5) Nëse në raportin e intervistës gjashtëmujore, punonjësi i drejtpërdrejtë epror i Institucionit Nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup me status të ofruesit të shërbimit publik në kulturë konstaton se ofruesi i shërbimit publik në kulturë efekti i të cilit monitorohet nuk i përmbush qëllimet e përcaktuara, përkatësisht tregon rezultate të pakënaqshme gjatë periudhës gjashtëmujore, nuk tregon ekspertizën dhe kompetencën e nevojshme, ka gabime të konsiderueshme në punë dhe sjelljen, i kryen detyrat e punës me kohë, përkatësisht nuk tregon interes për cilësinë e kryerjes së detyrave të punës, ai do të nisë një procedurë për përmirësimin e efektit.

(6) Në procedurën e përmirësimit të efektit, propozohet trajnimi ose mentorimi shtesë dhe shqiptohet sugjerim me shkrim në të cilin punonjësi paralajmërohet për mundësinë e vlerësimit me notë negative nëse, pavarësisht udhëzimeve dhe masave të propozuara, deri në skadimin e vitit për të cilin bëhet vlerësimi, nuk e përmirëson efektin e tij.

(7) Nëse ofruesi i shërbimit publik në kulturë efekti i të cilit monitorohet nuk ka punonjës të drejtpërdrejtë epror në Institucionin Nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup me status të ofruesit të shërbimit publik në kulturë, intervistën nga paragrafi (2) i këtij neni e bën, raportin nga paragrafi (3) i këtij neni e nënshkruan dhe procedurën për përmirësim të efektit e udhëheq personi udhëheqës në Institucionin Nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup.

Neni 8

(1) Punonjësit në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup me status të ofruesve të shërbimit publik në kulturë vlerësohen detyrimisht njëherë në vit dhe atë më së voni deri më 1 dhjetor për vitin rrjedhës.

(2) Vlerësimi nga paragrafi (1) i këtij neni e kryen ofruesi i drejtpërdrejtë epror i shërbimit publik në kulturë në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, e nëse ofruesi i shërbimit publik në kulturë që vlerësohet nuk ka ofrues të drejtpërdrejtë epror në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup me status të ofruesit të shërbimit publik në kulturë, vlerësimin nga paragrafi (1) të këtij neni e bën personi udhëheqës në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup (në tekstin e mëtutjeshëm: vlerësuesi).

Neni 9

(1) Të dhënat e marra gjatë vlerësimit, shënohen në Formularin për vlerësim të ofruesit të shërbimit publik në kulturë, që është dhënë në Shtojcën numër 1 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

(2) Formulari nga paragrafi (1) i këtij neni përmban:

- vulë katrore të Institucionit Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup me numër arkivor dhe datë;

I. Të dhënat për pjesëmarrësit në vlerësimin:

1. Emri dhe mbiemri i vlerësuesit
2. Vendi i punës i vlerësuesit
3. Emri dhe mbiemri i vlerësuesit
4. Vendi i punës i vlerësuesit

II. Të dhënat për qëllimet dhe detyrat e punës:

5. Përshkrimi i shkurtër i qëllimeve dhe detyrave të punës dhe detyrat e të vlerësuarit për vitin rrjedhës

III. Të dhëna tjera:

6. Të dhëna për punët e kryera të të vlerësuarit për vitin rrjedhës

IV. Të dhënat për vlerësimin:

7. Vlerësimi i ofruesit të shërbimit publik (në tabelë)

V. Masa për përmirësim:

8. Propozim-masa për përmirësimin e të vlerësuarit

VII. Komente:

9. Komenti i vlerësuesit

10. Komenti i të vlerësuarit

- nënshkrimi i të vlerësuarit

- nënshkrimi i vlerësuesit

- data, vendi dhe vula e Institucionit Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup.

(3) Kapitulli I, II dhe III nga formulari nga paragrafi (1) i këtij neni, i plotëson i vlerësuarit.

(4) Kapitullin IV nga formulari nga paragrafi (1) i këtij neni, e plotëson vlerësuesi, me ç'rast merren parasysh rezultatet e arritura në punë dhe kualitetet personale të ofruesit të shërbimit publik për periudhën për të cilin vlerësohet.

(5) Kapitulli V nga paragrafi (1) i këtij neni, plotësohet nga vlerësuesi.

(6) Vlerësuesi dhe i vlerësuar vlerësimin e dhënë mund ta arsyetojnë dhe të hapin komente të tyre për vlerësimin e dhënë, në kapitullin VI.

(7) Vlerësuesi dhe i vlerësuar e nënshkruajnë formularin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(8) Formulari nga paragrafi (1) i këtij neni ruhet në dosjen personale të ofruesit të shërbimit publik në kulturë, ndërsa ofruesi i shërbimit publik në kulturë merr kopje nga formulari.

Kritere për vlerësim

Neni 10

Vlerësuesi e vlerëson ofruesin e shërbimit publik në kulturë në bazë të:

- cilësisë, efektivitetit dhe efikasitetit të punës;
- respektit të afateve dhe etikës së punës;
- nivelit të përmbushjes së qëllimeve dhe detyrave të punës;
- nivelit të përfshirjes dhe përkushtimit të punës;
- kontributit në realizimin e programit vjetor për punën e Institucionit Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup;
- realizimit të planit individual për përsosje profesionale;
- sjelljes së ofruesit të shërbimit publik në kulturë.

Kritere më të afërta për vlerësim

Neni 11

Vlerësimi i ofruesit të shërbimit publik në kulturë në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup bëhet në bazë të kritereve më të afërta që kanë të bëjnë me rezultatet nga puna e tij, si dhe cilësitë personale që i ka treguar gjatë punës, dhe atë:

- profesionalizimi;
- vëllimi i punës (sa punë ka kryer);
- koha e duhur (kur i ka kryer punët);
- mëvetësi;
- kreativiteti;
- preciziteti;
- besueshmëria;
- bashkëpunimi;
- organizimi i punës;
- interdisiplinariteti
- sjellja ndaj palëve;
- komunikimi;
- aftësi tjera lidhur me punën.

Lloje të vlerësimeve

Neni 12

(1) Vlerësuesi e vlerëson ofruesin e shërbimit publik në kulturë me notën “5” me vlerë nga 4.51 deri në 5.00 – “veçanërisht dallohet” – dhe atë kur ofruesi i shërbimit publik në kulturë e tejkalon përmbushjen e qëllimeve dhe detyrave të punës për nivelin e vendit të punës në të cilin është sistematizuar në të gjitha sferat e punës së tij dhe jep kontribut të dukshëm në sferën që janë jashtë përgjegjësisë së tij të drejtpërdrejtë .

(2) Vlerësuesi e vlerëson ofruesin e shërbimit publik në kulturë me notën “4” me vlerë nga 3.51 deri në 4.50 – “dallohet” – dhe atë ofruesi i shërbimit publik në kulturë i përmbush qëllimet dhe detyrat e punës për nivelin e vendit të punës në të cilin është sistematizuar në të gjitha sferat e punës së tij.

(3) Vlerësuesi e vlerëson ofruesin e shërbimit publik në kulturë me notë “3”, me vlerë nga 2.51 deri në 3.50 – “mjaftueshëm” – dhe atë kur ofruesi i shërbimit publik në kulturë i përmbush qëllimet dhe detyrat e përcaktuara të punës për nivelin e vendit të punës në të cilin është sistematizuar në të disa sfera në punën e tij.

(4) Vlerësuesi e vlerëson ofruesin e shërbimit publik në kulturë me notë “2” me vlerë nga 1.51 deri 2.50 – “pjesërisht mjaftueshëm” – dhe atë kur ofruesi i shërbimit publik në kulturë në nivel të ulët i përmbush qëllimet dhe detyrat e përcaktuara të punës për nivelin e vendit të punës në të cilin është sistematizuar.

(5) Vlerësuesi e vlerëson ofruesin e shërbimit publik në kulturë me notë “1”, me vlerë nga 1.00 deri – “pamjaftueshëm” dhe atë kur ofruesi i shërbimit publik në kulturë nuk i përmbush qëllimet dhe detyrat e përcaktuara për nivelin e vendit të punës në të cilin është sistematizuar.

Mënyra e vlerësimit

Neni 13

Vlerësimi bëhet në mënyrë objektive dhe të paanshme, pa ndikim dhe presion nga ofruesit e drejtpërdrejtë udhëheqës epror të shërbimeve publike në kulturë mbi vlerësuesin.

Neni 14

(1) Vlerësimi vjetor i ofruesve të shërbimit publik në kulturë fitohet në bazë të notës së vlerësuesit, me faktor të peshës nga 65%, si dhe nga nota mesatare e dy ofruesve tjerë të shërbimit publik në kulturë në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup (në tekstin e mëtutjeshëm: vlerësues tjerë), me faktor të peshës prej 35%.

(2) Vlerësuesit tjerë i zgjedh ofruesi i shërbimit publik në kulturë dhe ato janë me nota nga “1” deri në “5” i vlerësojnë kompetencat e përgjithshme të punës të ofruesit të shërbimit publik në kulturë dhe propozojnë mënyra për përmirësimin e punës së tij.

(3) Vlerësuesi gjatë plotësimit të formularit për vlerësim vjetor i cili e bën në prezencë të ofruesit të shërbimit publik në kulturë, realizon dhe plotëson detyrimisht formular për intervistë të realizuar vjetor të karrierës të ofruesit të shërbimit publik në kulturë.

(4) Përmes realizimit të intervistës vjetore të karrierës, ofruesi i shërbimit publik në kulturë prononcohet për: planet personale lidhur me sistematizimin ose avancimin e tij, nevojat për trajnime specifike me qëllim avancimin e punës së tij, vërejtjet lidhur me mënyrën e funksionimit të njësisë organizative dhe ngjashëm.

Procedura e vlerësimit në rrethana tjera

Neni 15

(1) Ofruesi i shërbimit publik në kulturë i cili gjatë vitit për të cilin bëhet vlerësimi, ka munguar në punë më shumë se gjashtë muaj (pushim mjekësor, pushim pa pagesë etj.) si dhe ofruesi i shërbimit publik në kulturë i cili për herë të parë është punësuar dhe ka punuar më pak se gjashtë muaj në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi, nuk do të vlerësohet.

(2) Vlerësimin e ofruesit të shërbimit publik në kulturë, i cili gjatë vitit për të cilin bëhet vlerësimi është sistematizuar, përkatësisht është transferuar nga vend tjetër pune, e bën vlerësuesi i ri, në bazë të raportit me shkrim nga vlerësuesi paraprak.

(3) Nëse vlerësuesi gjatë vitit për të cilin bëhet vlerësimi e ndërron vendin e punës, ose do t'i ndërpritet marrëdhënia e punës, vlerësimin e ofruesve të shërbimeve publike me të cilat ka udhëhequr, e bën vlerësuesi i ri, në bazë të raportit me shkrim nga vlerësuesi paraprak.

Neni 16

(1) Pas përfundimit të vlerësimit, kopje e formularit nga neni 9 paragrafi (1) i kësaj Rregulloreje, si dhe mostër të formularit për intervistën vjetore të karrierës nga neni 14 paragrafi (3) i kësaj rregulloreje, i dorëzohet edhe ofruesit të shërbimit publik në kulturë.

(2) Vlerësuesi është i detyruar që të përgatisë dhe më së voni deri më 31 dhjetor, njësisë organizative kompetente për menaxhim me resurse njerëzore, përkatësisht personit kompetent për kryerje të punëve nga sfera e menaxhimit me resurse njerëzore, të dorëzojë raport me ranglistë të notave vjetore të të gjithë ofruesve të shërbimeve publike në kulturë që i ka vlerësuar, si dhe mostër të formularit për vlerësimin e kryer dhe intervistën vjetore të karrierës.

(3) Formulari për raportin me ranglistë nga paragrafi (3) i këtij neni është dhënë në Shtojcë numër 2 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Shuma e shpërblimit në para ose lloj tjetër i shpërblimit material dhe jomaterial, zvogëlimi i rrugës ose sistematizimi në vendin e punës në nivel më të ulët

Neni 17

(1) Pas vlerësimit dhe procedurës së kryer me ankesë të vlerësimeve në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, nga njësisia organizative kompetente për menaxhim me resurset njerëzore, përkatësisht nga personi kompetent për kryerje të punëve nga sfera e menaxhimit me resurse njerëzore, përgatitet ranglista finale e notave të të gjithë ofruesve të shërbimit publik në kulturë në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, të shprehur në vlerë nominale.

(2) Në pajtim me ranglistën finale nga paragrafi (1) i këtij neni, ofruesit e shërbimeve publike në kulturën në Institucionin Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup që janë vlerësuar me notën “5” do të

shpërblehen me shpërblimin në shumë prej një rroge bazë të ofruesit të shpërblyer të shërbimit publik në kulturë, nëse në Buxhetin e institucionit janë siguruar mjete për atë dedikim. Nëse në Buxhetin nuk janë siguruar mjete, ofruesi i shpërblyer i shërbimit publik mund të shpërblehet me ditë të lira ose lloj tjetër të shpërblimit jomaterial.

(3) Ofruesve të shërbimeve publike në kulturë të cilët janë të vlerësuar me notën “1”, do t’u zvogëlohet rroga bazë në shumë prej më së shumti 20% në periudhë prej tre muajsh.

(4) Ofruesi i shërbimit publik në kulturë i cili do të jetë i dënuar me dënim në para në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, në vitin në të cilin është vlerësuar me notën “1”, nuk mund të dënohet në procedurë disiplinore për shkak të rezultateve të dobëta në punë.

(5) Ofruesit të shërbimit publik në kulturë i cili tre vite me radhë përkatësisht tre vite gjatë pesë viteve të vlerësimit, do të vlerësohet me notën “1” i ndërpritet marrëdhënia e punës, në procedurë të përcaktuar me ligj.

(6) Ofruesi i shërbimit publik në kulturë i cili tre vite me radhë do të vlerësohet me notën “2”, do të sistematizohet në vend pune më të ulët për të cilin i përmbush kushtet e përcaktuara në aktin për sistematizim të Institucionit Nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup.

(7) Për shpërblimin, përkatësisht për reduktimin e rrogës së ofruesve të shërbimeve publike në kulturë, përkatësisht për sistematizimin në vendin e punës në nivel më të ulët, vendos Bordi Drejtues i Institucionit Nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në bazë të ranglistës finale nga paragrafi (1) i këtij neni.

E drejta e ankesës

Neni 18

Ofruesi i shërbimit publik në kulturë, i cili nuk është i kënaqur nga vlerësimi, mund që në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të kopjes së formularit nga neni 9 paragrafi (1) i kësaj rregulloreje dhe nga kopja e formularit për intervistën vjetore të karrierës nga neni 14 paragrafi (3) të kësaj rregulloreje, të parashtrojë ankesë në Bordin Drejtues të Institucionit Nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup.

Dispozita përfundimtare

Neni 19

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve të Institucionit Nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup.

**Bordi Drejtues i Institucionit
Nacional Galeria Nationale e
Republikës së Maqedonisë së
Veriut – Shkup,
Kryetar
Prof. Lladisllav Cvetkovski**

Shtojca numër 1

(vula katrore e institucionit)

**FORMULAR PËR VLERËSIMIN E OFRUESIT TË SHËRBIMIT PUBLIK NË KULTURË
NË INSTITUCIONIN NACIONAL GALERIA NACIONAL E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT – SHKUP
PËR VITIN _____**

I. Të dhënat për pjesëmarrësit në vlerësimi

1. Emri dhe mbiemri i të vlerësuarit _____
2. Vendi i punës i të vlerësuarit _____
3. Emri dhe mbiemri i vlerësuesit _____
4. Vendi i punës i vlerësuesit _____

II. Të dhënat për qëllimet dhe detyrat e punës

5. Përshkrim i shkurtër i qëllimeve dhe detyrave të punës të ofruesit të shërbimeve publike në kulturë për vitin rrjedhës

III. Të dhëna tjera

6. Të dhëna për punët e kryera të ofruesit të shërbimeve publike në kulturë për vitin rrjedhës

IV. Të dhënat për vlerësimin

7. Vlerësimi i ofruesit të shërbimit publik në kulturë

| | |
|--|--|
| Cilësi, efektivitet dhe efikasitet i punës | |
| Respektimi i afateve dhe etikës në punë | |
| Niveli i përmbushjes së qëllimeve dhe detyrave të punës | |
| Niveli i përfshirjes dhe përkushtimit në punë | |
| Kontributi në realizimin e programit vjetor të Institucionit Nacional Galeria Nationale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup | |
| Realizimi i planit individual për përsosje profesionale | |
| Sjellja e ofruesit të shërbimit publik në kulturë | |
| Nota e vlerësuesit | |

V. Masat për përmirësim

8. Propozim-masa për përmirësim të ofruesit të shërbimit publik në kulturë

VI. Komente

9. Komenti i vlerësuesit

10. Komenti i të vlerësuarit

Vlerësuesi _____

I vlerësuar _____

(V.I.)

Shtojca numër 2

(vula katrore e institucionit)

**RAPORT PËR VLERËSIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMIT PUBLIK NË KULTURË
NË INSTITUCIONIN NACIONAL GALERIA NACIONALE E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT – SHKUP
PËR VITIN _____**

1. Të dhënat për numrin e ofruesve të vlerësuar dhe të pavlerësuar të shërbimit publik në kulturë

2. Shkaqet e mosvlerësimit

3. Komente tjera

4. Ranglista e vlerësimeve të kryera të ofruesve të shërbimeve publike në kulturë

| Nr. rend. | Emri dhe mbiemri | Vendi i punës | Nota |
|-----------|------------------|---------------|------|
| 1. | | | |
| 2. | | | |
| 3. | | | |
| 4. | | | |
| | | | |

Vlerësuesi: _____

(V.I.)